



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 1, datë 10.01.2022

MBI

**“NJOFTIMIN ZYRTAR TË SIPËRMARRËSIT ALBTELECOM SH.A. PËR
NDRYSHIMIN E STRUKTURËS AKSIONARE TË SHOQËRISË TREGTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira Dvorani	Anëtare
3. Znj. Ketrin Topçiu	Anëtare
4. Znj. Xhoana Lilaj	Anëtare
5. Z. Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Elsona Mosho (caktuar me Urdhërin nr.1, datë 07.01.2022), në mbledhjen e datës 10.01.2022, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **“Njoftimin zyrtar të sipërmarrësit Altelecom Sh.a. për ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë tregtare”**

BAZA LIGJORE:

1. Gërma ç), pika 2 e nenit 71, neni 74, pika 1 dhe 3 e nenit 114, pika 1 e nenit 115 të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH, i ndryshuar” (**Ligji nr. 9918/2008**);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr.44/2015**)
3. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013 “Për per dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr.30/2013**).

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Njoftimi i sipërmarrësit Albtelcom Sh.a. për ndryshimin e strukturës së aksionarëve, protokolluar në AKEP me nr.2502, datë 21/12/2021;
2. Kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës, protokolluar nga AKEP me nr.2502/1 datë 28/12/2021;
3. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projekt vendimit (**Relacioni**);
4. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “Albtelcom” Sh.a nëpërmjet njoftimit zyrtar (pjesë e praktikës dokumentare) ka kërkuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhënien e miratimit paraprak për ndryshimin e strukturës së aksionarëve në favor të shoqërisë hungareze “4iG”, duke deklaruar se në strukturën aksionare të kësaj shoqërie nuk ka asnjë pjesëmarrje apo kontroll të çfarëdo lloji të operatorëve të tjerë të komunikimeve elektronike në Shqipëri.
2. Njoftimi mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë “Albtelcom” Sh.a. nga shoqëria “4iG”, përmes blerjes dhe zotërimit të 80.27% të kapitalit aksionar të shoqërisë “Albtelcom” Sh.a. është përcjellë dhe pranë Autoritetit të Konkurrencës. Në zbatim të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacion nga AKEP mbi vendimmarrjen e saj sa i përket ndryshimit të strukturës aksionare të shoqërisë “Albtelcom” Sh.a.
3. Këshilli Drejtues i AKEP pasi ka marrë në vlerësim kërkesën e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Albtelcom” Sh.a., në referim të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e komunikimeve elektronike, si dhe nën dritën e praktikës së vendosur deri më tani në AKEP për rastet e kalimit të pronësisë apo ndryshimit të strukturave aksionare të shoqërive që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike të pajisur me Autorizim Individual për përdorimin civil të spektrit të frekuencave, konstaton të domosdoshme të sqarojë *ratio legis* të normës juridike që përcaktohet në nenin 71 dhe 74 të Ligjit nr.9918/2008, si dhe dispozitat që rrjedhin prej saj në aktet rregullatore të miratuara nga AKEP.
4. Referuar nenit 8 të Ligjit nr. 9918/2008, AKEP lëshon Autorizime Individuale për përdorimin e brezave të frekuencave sipas Planit Kombëtar të Frekuencave. Administrimi i Spektrit të Frekuencave të caktuar për qëllime civile në sektorin e komunikimeve elektronike, rregullohet nga Kreu VII i Ligjit nr.9918/2008. Referuar dispozitave të këtij kreu, në dhënien në përdorim të frekuencave sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm dhe atij Individual, AKEP mban parasysh se frekuencat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe sociale. Mbështetur në rëndësinë e tyre dhe faktin se frekuencat janë burime të fundme, ligjvënësi ka parashikuar një sër kushtesh dhe kriteresh sa i përket dhënies në përdorim të frekuencave kombëtare, shfrytëzimit të tyre nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, vlefshmërisë se tyre, si dhe procedurës së transferimit të së drejtës së përdorimit nga një sipërmarrës tek një tjetër.

5. Neni 71 dhe 74 i Ligjit nr.9918/2008 e lidhin ngushtësisht detyrimin e çdo sipërmarrësi të pajisur me Autorizim Individual për të kërkuar dhënien e miratimit paraprak nga AKEP, me të drejtën e tyre për të kërkuar transferimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave për qëllime civile nga një sipërmarrës tek një tjetër.
6. Sipas dispozitave të cituara më lart, AKEP vendos kushte në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave ndër të tjera dhe për: “...transferimin e të drejtave të pronësisë për përdorimin e frekuencave dhe kushteve për këtë transferim...”. Ky parashikim nuk mund të interpretohet më vete apo i ndarë nga rregullimi që jepet në nenin 74, në të cilin parashikohet procedura e transferimit të Autorizimit Individual. Referuar nenit 74 të Ligjit nr.9918/2008, ndalohet transferimi i të drejtës për përdorimin e frekuencave nga një sipërmarrës tek një tjetër nëse për këtë transferim nuk është dhënë, paraprakisht, miratimi nga AKEP.
7. Në kuptim të sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP gjen me vend të sqarojë se ligji bazë sektorial nuk përcakton në asnjë moment detyrimin e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, mbajtës të së drejtës së përdorimit të frekuencave kombëtare, për të kërkuar dhënien e miratimit paraprak nga AKEP në rastet e ndryshimit të strukturës aksionare së tyre. Mbetet e qartë për AKEP, se veprimtaria apo funksioni rregullator që ushtron në sektorin e komunikimeve elektronike kufizohet vetëm sa i përket mbikëqyrjes apo kontrollit të përdorimit eficient dhe korrekt të frekuencave kombëtare në përputhje me objektivat rregullator, dhe jo rregullimit apo kontrollit sa i përket marrëveshjeve të bashkërenduara midis dy apo më shumë shoqërive.
8. Interpretimi i mësipërm ligjor, është parashikuar dhe trajtuar nga AKEP dhe në nenin 7 të Rregullores nr.30/2013, duke specifikuar kushtet e pranimit të një transferimi të mundshëm të Autorizimeve Individuale nga një sipërmarrës tek një tjetër. Në referim me këtë dispozitë, AKEP thekson se pavarësisht trajtimit ligjor në këtë vendim sa i përket kërkesës për dhënie të miratimit paraprak të kalimit të pronësisë, njoftimi i ndryshimeve strukturore është i nevojshëm në kuptim të kryerjes së procedurave administrative të parashikuara nga pika 4 e nenit 7 të Rregullores nr.30/2013.
9. Në rastin objekt shqyrtimi, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se nuk jemi përpara momentit procedural të transferimit të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave, pasi nga sipërmarrësi “Albtelecom” Sh.a. nuk kërkohet transferimi i të gjitha apo i një Autorizimi Individual që ka në përdorim, por ka njoftuar mbi ndryshimin e strukturës aksionare. Përfundimi i kontrollit të shoqërisë “Albtelecom” Sh.a. nga shoqëria blerëse nëpërmjet ndryshimit të strukturës aksionare, nuk përfshin procesin e transferimit të së drejtës për përdorimin e frekuencave nga një sipërmarrës tek një tjetër dhe për rrjedhojë, shoqëria “Albtelecom” Sh.a. do të vijojë të jetë mbajtës i Autorizimeve Individuale të lëshuara nga AKEP për qëllime të përmbushjes së aktivitetit të tij tregtar.
10. Këshilli Drejtues i AKEP vlerëson në vijim se arsyetimi ligjor si më sipër gjen zbatim për çdo Autorizim Individual të lëshuar për përdorimin e frekuencave kombëtare që përdoren për qëllime civile, dhe se kushtet e përcaktuara për çështjet e pronësisë në AI duhet t’i referohen vetëm

momentit procedural të transferimit të AI nga një sipërmarrës tek një tjetër, sipas përcaktimit të nenit 74 të Ligjit nr.9918/2008.

11. Në përfundim, Këshilli Drejtues i AKEP thekson se në vlerësim të legjislacionit në fuqi që rregullon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, mbetet në kompetencë të Autoritetit të Konkurrencës, si institucion përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës efektive, vlerësimi apo verifikimi nëse marrëveshja e lidhur midis dy shoqërive paraqet kushtet apo riskun e kufizimit apo dëmtimit të konkurrencës në treg.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1, të nenit 114, pikën 1, të nenit 115, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore të cituara në këtë Vendim, Këshilli Drejtues i AKEP:

V E N D O S I:

1. Të miratojë qëndrimin e AKEP lidhur me njoftimin zyrtar të sipërmarrësit “Albtelecom” Sh.a. duke mos u shprehur sa i përket kërkesës për dhënien e miratimit paraprak për ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë tregtare.
2. Të unifikojë qëndrimin sa i përket *ratio legis* të nenit 71 dhe 74 të Ligjit nr.9918/2008, mbi dhënien e miratimit paraprak vetëm sa i përket rasteve të transferimit të së drejtës së përdorimit të Autorizimeve Individuale nga sipërmarrësi mbajtës i kësaj të drejte tek një sipërmarrës tjetër.
3. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për njoftimin e këtij vendimi të gjithë sipërmarrësve të komunikimeve elektronike mbajtës të Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtare	Anëtare	Anëtare	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Xhoana Lilaj	Lorenc Bako